



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.4.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË ISTOGUT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndërmerret edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërdrejt llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Istogut në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga, Mehmet Muçaj (Udhëheqës Ekipi), Faik Thaqi (anëtar i ekipit), dhe Elvir Krasniqi (anëtar i ekipit).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	7
2 Pasqyrat Vjetore Financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm.....	9
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	12
4 Qeverisja	13
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP.....	24
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	27


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Istogut për vitin 2014, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit të datës 22.10.2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinionit të Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejt dhe të vërtet në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të çështjeve:

Komuna kishte bërë klasifikim të gabuar të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar për mallra dhe shërbime dhe subvencione e transfere vlerën 227,778€; dhe

Komuna kishte bërë një pagesë të parregullt (43,104€) për një projekt që nuk ishte implementuar gjatë vitit 2014.

Theksimi i çështjes


Dëshirojmë gjithashtu të përmendim faktin se vlerat e pasurive të regjistruara në PVF ishin jo të plota, pasi që në SIMFK nuk janë regjistruar 1,565 parcela tokësore dhe situacionet e paguara si investime në vijim, ishin regjistruar si projekte finale në vlerë 345,216€.


(SNISA: 200/1705: Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes).

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i komunës kishte dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm në nivel të kënaqshëm, megjithatë sistemi duhet të monitorohet për siguar se kontrollet e brendshme janë duke vepruar në vazhdimësi.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:





Përgjigja nga Menaxhmenti – auditimi për 2014

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha gjetjet e auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet tona.

Ne e marrim si punë të kryer që Kryetari:

- Të diskutoj Raportin e Auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Gjatë muajit Janar/shkurt 2016 të inicioj diskutimet në Asamblenë Komunale lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2015 të jenë dorëzuar në Ministrinë e financave.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Menaxhmentit të komunës të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF dhe të dhënave tjera financiare, si dhe të shpreh e opinionin:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë, të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien në mënyrë efikase të produkteve operative cilësore. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Për këtë nevojitet një vlerësim i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato janë konsideruar si relevante. Në fazën e ndërmjetme të auditimit, ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para përgatitjes së PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët, do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurave vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat Vjetore Financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Kryetari i Komunës dhe Zyrtaari Kryesor Financiar (ZKF), për PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Deklarata ka për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni jonë i përgjithshëm lidhur me PVF-të është se janë identifikuar disa gabime si: keq klasifikimi në kode jo adekuate, pagesat e parregullta dhe shpalosjet e pasurive. Ndërsa kërkesat e raportimit të jashtëm ishin plotësuar.

2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejt dhe të vërtet në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të çështjeve:

Komuna kishte bërë klasifikim të gabuar të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar për mallra dhe shërbime dhe subvencione e transfere vlerën 227,778€; dhe

Komuna kishte bërë një pagesë të parregullt (43,104€) për një projekt që nuk ishte implementuar gjatë vitit 2014.

Theksimi i çështjes

Dëshirojmë gjithashtu të përmendim faktin se vlerat e pasurive të regjistruara në PVF ishin jo të plota, pasi që në SIMFK nuk janë regjistruar 1,565 parcela tokësore dhe situacionet e paguara si investime në vijim ishin regjistruar si projekte finale në vlerë 345,216€.

(SNISA: 200/1705 Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes).

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të dërguar me 22/10/2014, janë identifikuar dy rreziqe domethënëse në PVF lidhur me plotësinë e pasurive dhe pagesave nga palët e treta. Rreziqet e anomalive materiale që ne i kemi identifikuar kanë ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprime për të adresuar rreziqet e paraqitura.

Rreziku i identifikuar

Çështja 1- Mos regjistrim i pagesave nga palët e treta.

Përgjigja dhe të gjeturat e auditimit

Ne kemi shqyrtuar financimet e projekteve dhe pagesat e bëra për komunën nga ana e donatorëve të jashtëm. Ne kemi konstatuar se Menaxhmenti nuk ka ndonjë bazë të të dhënave lidhur me financimet e projekteve nga donatorët e jashtëm dhe si pasojë e kësaj, nuk ka prezantuar asnjë vlerë si pagesë nga palët e treta në PVF.

Rekomandimi 1 Prioritet i lartë - Kryetari duhet të siguroj që për financimet e projekteve të cilat bëhen nga donatorët e jashtëm, të mbahen të dhëna të plota në mënyrë që të prezantohen në PVF si pagesa nga palët e treta.

Rreziku i identifikuar

Çështja 2 - Mos regjistrimi i të gjitha pasurive në pronësi të Komunës do të rezultojë në nënvlerësim material të vlerave të pasurive në PVF

Përgjigja dhe gjetjet e auditimit

Nuk ka ndonjë progres të theksuar në regjistrimin e pasurive. Ne i kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për ta dëshmuar plotësinë e të dhënave të pasurive. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet për të siguruar që vlera e pasurive në PVF të ishte e saktë. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar sepse Menaxhmenti në fund të vitit 2014 nuk kishte arritur të aplikojë përmirësimet e nevojshme. Së këndejmi, vlerat e pasurive të regjistruara në PVF ishin jo të plota, pasi që në SIMFK nuk ishin regjistruar 1,565 parcela tokësore dhe situacionet e paguara si investime në vijim, janë regjistruar si projekte finale në vlerë 345,216€. Për mangësi të njëjta, Theksimi i Çështjes është aplikuar në opinionin e vitit 2013.

Rekomandimi 2 Prioritet i lartë- Kryetari duhet të analizojë arsyet për Theksim të Çështjes për vitin 2013 dhe të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në vitin 2015.

2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

Komuna duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ajo kishte përmbushur kërkesat raportuese si në vijim:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048;
- Raportet Operacionale (performancës); dhe
- Draft Plani dhe Plani Përfundimtar i prokurimit me kohë.

Komuna kishte përgatitur PVF me një vonës prej 9 ditësh. Ato ishin përgatitur me 09.02.2015 dhe ishin dorëzuar në MF.

Në draft Pasqyrat Financiare ishte nevojshme që të bëhen disa korrigjime financiare dhe ne kemi dhënë edhe disa sugjerime të tjera për përmirësime. Më pas, PVF janë përmirësuar. Mirëpo, përkundër përmirësimeve, mangësitë janë përshkruar si më poshtë:

Çështja 3 - Procesi i përgatitjes së PVF - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna e Istogut kishte keq deklaruar në PVF shpenzimet e investimeve kapitale, ku nga kategoria e investimeve kishte paguar mallra dhe shërbime dhe subvencione e transfere në vlerë prej 227,778€;

Komuna kishte bërë një pagesë të parregullt (43,104€) për një projekt që nuk ishte implementuar plotësisht gjatë vitit 2014. (Për më shumë, shih çështja 9); dhe

Shënimi 31: Përmbledhje e pasurive jo financiare kapitale, totali i pasurive me vlerë mbi 1,000€ në PVF ishte 12,262,984€ në vlerën neto. Në këtë vlerë nuk ishin përfshirë pronat komunale dhe disa projekte kapitale ishin regjistruar si të përfunduara derisa ato në fakt janë investime në vijim. Për më shumë, referoju kapitullit 2.2 të këtij raporti.

Rreziku Paraqitja jo e saktë e PVF dhe gabimeve të identifikuara në shumat e regjistruara, shpie në një keqkuptim të pozitës financiare të komunës dhe ka ndikim potencial negativ në saktësinë e kërkesave të ardhshme buxhetore.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të sigurojë që plani për hartimin e PVF të vitit 2015 të adresojë formalisht të gjitha kërkesat e që kanë të bëjnë me cilësinë e informatave. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe Zyrtari Kryesor Financiar nuk duhet të dorëzohet, përveç nëse draft PVF janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar një plan për adresimin e rekomandimeve nga viti paraprak. Megjithatë, vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2013 të Komunës kishte rezultuar me 13 rekomandime. Deri në fund të auditimit për vitin 2014, katër (4) rekomandime ishin adresuar plotësisht, pesë (5) ishin adresuar pjesërisht, dhe 4 nuk ishin adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Çështja 4 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- E gjetura** Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar, sepse komuna nuk ka kryer një proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-it.
- Rreziku** Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe kanë rezultuar në problemet e njëjta sikurse në vitin e kaluar, si: deklarimi jo i plotë i pasurive, vonesa në përmirësimin e kontrolleve që ndërlidhen me inkasimin e të hyrave, pagesa para se të kryhen punimet, pagesat nga kodet jo adekuate ekonomike, etj.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit të përcaktojë një afat kohor konkret për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga Kryetari i Komunës në mënyrë sistematike.

4 Qeverisja

Konkluzion i Përgjithshëm

Komuna e Istogut nuk i ka adresuar gabimet materiale në pasuritë e regjistruara në PVF. Pavarësisht kësaj, cilësia e PVF në përgjithësi ishte e mirë, ku ne identifikuam vetëm një numër të vogël gabimesh jo materiale dhe të gjitha kërkesat e raportimit ishin plotësuar. Obligimet e tjera të raportimit të jashtëm ishin përmbushur plotësisht, me përjashtim raportimit mujor të obligimeve. Megjithatë, komuna ka arritur të adresoj mirë shkurtimin buxhetor prej 15% tek mallrat dhe shërbimet dhe raporti i jashtëm i auditimit është diskutuar në asamblenë komunale.

Vetë-vlerësimi – ishte inciuar mirëpo nuk ishte kompletuar gjatë kohës kur ne ishim në auditim, megjithatë ne inkurajojmë që komuna të zbatojë një qasje kritike gjatë vetëvlerësimit si një pikë fillestare për përmirësimin e performances aty ku është e nevojshme.

Menaxhimi i rrezikut – komuna ende nuk ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara për identifikimin dhe menaxhimin e rrezikut, të cilat do të zbusnin ekspozimin ndaj rreziqeve që ndërliken me objektivat e komunës.

Ne kemi gjetur se kontrollet mbi procesin e planifikimit të të hyrave nuk janë të mira dhe nuk janë analizuar në mënyrë të qëndrueshme, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojnë komunën që të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për parane dhe menaxhim jo efektiv të projekteve.

Çështja 5 - Proceset e llogaridhënies – Prioriteti i lartë

E gjetura Pas rishikimit të kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të komunës, rezultojnë dobësi evidente në raportim. Forma e raportimit që bëhet tek kryetari bëhet sipas nevojës dhe nuk ka raportime me shkrim prej drejtorëve në baza të rregullta mbi punët dhe aktivitetet e tyre. Ne nuk jemi mbështetur në funksionimin e kontrolleve të nivelit të lartë për të hyrat, mallrat dhe shërbimet, subvencionet dhe transferet, dhe investime kapitale.

Rreziku Raportimi jo i rregullt me shkrim nga ana e drejtorëve tek Kryetari i Komunës, redukton aftësinë e menaxhmentit për të drejtuar në mënyrë efektive aktivitetet e komunës, për të reaguar ndaj sfidave financiare në kohën e duhur dhe për të zbatuar kontrollin efektiv të buxhetit.

Rekomandimi 5 Kryetari duhet të sigurojë që rishikimi është kryer për të përcaktuar formatin e raportimit financiar për menaxhmentin e lartë që është kërkesë për mbështetjen e një menaxhimi efektiv të punës. Kjo duhet të mbështetet nga një strukturë qeverisëse ku menaxhmenti i lartë është i njoftuar mbi rreziqet, dobësitë e kontrolleve dhe t'i menaxhojë ato në mënyrë aktive.

4.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Në kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për Komunën e Istogut, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	7,789,708	8,738,017	8,176,752	8,339,097	7,855,664
Granti i Qeverisë -Buxheti	6,844,708	7,555,922	7,420,977	7,406,811	6,988,068
Të bartura nga viti paraprak ²	0	188,922	106,245	144,464	233,888
Të hyrat vetanake ³	945,000	945,000	606,985	683,436	608,049
Donacionet e brendshme	0	30,090	24,465	48,789	24,909
Donacionet e jashtme	0	18,083	18,080	55,597	750

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 948,309€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore dhe të jashtme (48,173€), të hyrave të bartura nga viti paraprak (188,922€), dhe rritja e grantit qeveritar për shkak të rritjes së pagave (711,214€).

Në vitin 2014, Komuna e Istogut ka shpenzuar 94% të buxhet final që krahasuar me vitin paraprak kemi një rënie për 162,184€ të ekzekutimit të buxhetit. Rënia e ekzekutimit të buxhetit është në kategorinë e të hyrave vetjake.

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Të hyrat vetanake komunale të buxhetuara dhe të shpenzuara

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimet	2012 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	7,789,708	8,738,017	8,176,752	8,339,097	7,855,664
Pagat dhe Mëditjet	4,356,810	5,068,024	5,046,011	4,318,168	4,272,524
Mallrat dhe Shërbimet	709,200	720,791	629,647	864,385	1,019,243
Shërbimet komunale	148,358	148,775	126,008	187,559	149,952
Subvencionet dhe Transferet	214,750	285,328	168,359	359,903	322,123
Investimet Kapitale	2,360,590	2,515,099	2,206,727	2,609,082	2,091,822

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes në buxhetin për shpenzime kapitale gjatë vitit, rreth 88% e buxhetit ishte shpenzuar;
- Rritja e buxhetit për Paga dhe Mëditje me 711,214€ dhe Mallra dhe Shërbime për 11,591€ është si rezultat të hyrat e bartura nga viti i mëparshëm; dhe
- Ekzekutimi i buxhetit në vitin 2014 është rreth 94%, nëse krahasojmë me vitin 2013 (96%) vërejmë një rënie në ekzekutimin e buxhetit.

Çështja 6 - Pagesa sipas vendimeve gjyqësore- Prioritet i mesëm

E gjetura Komuna e Istogut gjatë vitit 2014 sipas shënimeve të furnitorëve ka shpenzuar 2,017€ nga vendimet gjyqësore.

Rreziku Ekzekutimi i pagesave të tilla të pa planifikuara rritë rrezikun që të mos realizohen projektet e planifikuara dhe paraqet rrezik që komuna të mos arrij objektivat e caktuara.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të siguroj pagesën e faturave me kohë dhe të evitoj rrezikun që pagesat të ekzekutohen përmes vendimeve gjyqësore.

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e Komunës - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat	945,000	945,000	936,047	683,436	608,049

Të hyrat vetjake për këtë periudhë janë realizuar në nivelin 99% të buxhetit për vitin 2014, dhe kanë treguar rritje prej 252,608 apo 37% në krahasim me të hyrat në vitin 2013. Vërehet se komuna ka një trend të rritjes së vazhdueshme të hyrave vetjake.

4.2 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Përshkrimi

Komuna e Istogut ka të vendosura kontrole që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave. Megjithatë, ekziston nevoja për përmirësimin e disa proceseve për ta mbështetur saktësinë dhe plotësinë. Në procesin e mbledhjes, identifikuaam çështjet si në vijim:

Çështja 7 - Mbledhja e të hyrave- Prioritet i lartë

E gjetura Komuna nuk ka hartuar një politikë për mbledhjen e borxheve të mbetura nga tatimi në pronë (1,019,763€), lejet e ndërtimit (97,471€) dhe taksa në veprimtari (182,933€).

Po ashtu, identifikuaam se me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronave komunale me qira, komuna nuk kishte respektuar rregulloren e brendshme duke mos organizuar procedurën e ankandit publik.

Rreziku Mos hartimi i një politike për inkasimin e të hyrave vetjake ndikon që të hyrat tanimë të faturuara të mos realizohen dhe kjo redukton mundësinë e realizimit të projekteve të buxhetuara nga të hyrat vetjake. Dhënia e tokës pa organizuar ankand publik paraqet rrezik të zgjedhjes së gabuar, duke e kufizuar ofertën e tregut dhe e dëmton parimin e konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë për të gjithë te interesuarit.

Rekomandimi 7 Kryetari duhet të siguroj një strategji duke i vendosur, specifikuar të gjitha masat dhe mekanizmat e duhur për inkasimin e borxheve të mbetura nga vitet e kaluara. Po ashtu, kryetari duhet të siguroj organizimin e ankandeve publike në rastet e dhënies me qira të pronave komunale.

4.3 Shpenzimet

4.3.1 Prokurimi

Përshkrimi

Komuna e Istogut për vitin 2014 për kategorinë Investime Kapitale dhe Mallra dhe Shërbime kishte shpenzuar 2,962,561€. Pre tyre kemi testuar 1,274,920€ apo 43% dhe 16 mostra për aktivitetet e prokurimit në vlerë 856,387€.

Testimet tona kanë venë në pah mangësitë në vijim:

Çështja 8 - Dobësitë sistematike në prokurim – Prioritet i lartë

E gjetura Komuna ka bërë vazhdimin e afatit për kontratat kornizë në kundërshtim me neni 38.2 të LPP ku thotë që kontrata publike kornizë nuk mund të zgjatet apo të ri-përtërihet. Rastet që janë vazhduar kontratat kornizë janë:

- Furnizim me artikuj ushqimor dhe higjienik;
- Riparimin e rrugëve lokale;
- Material shpenzues për zyre për institucionet e Komunës së Istogut; dhe
- Furnizim me karburante.

Në projektin “Izolimi dhe Fasadimi i Shkollës Fillore “Avni Rrustemi”, komuna kishte shpërblyer me kontratë Operatoret Ekonomik (OE) të pa përgjegjshëm. Këtij OE i mungonin dëshmi mbi pronësinë e pajisjeve, kriteret të cilat ishin të kërkuara në dosje të tenderit.

Ne identifikua 15 raste (pagesa) ku komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve me një vlerë totale 227,778€. Pagesat ishin bërë nga kategoria e investimeve kapitale derisa shpenzimet ishin për subveçnionet dhe mallra dhe shërbime.

Rreziku Vazhdimi i kontratave kornizë përveç që është në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit, e pamundëson konkurrencën e lirë dhe për pasojë komuna mund të ketë shpenzim më të lartë sesa kushtet e tregut.

Shpërblimi me kontratë OE të pa përgjegjshëm paraqet rrezik që në procesin e ekzekutimit punimet të mos jenë të kualitetit të pritur.

Keq klasifikimi i shpenzimeve ndikon në mbivlerësim të shpenzimeve kapitale dhe nën vlerësim të kategorisë subveçnionet dhe transfere.

Rekomandimi 8 Kryetari duhet të siguroj se:

Të mos vazhdohet asnjë kontratë kornizë dhe të respektoj kriteret sipas Dosjeve të Tenderit, në mënyrë që të shpërblehen me kontratë vetëm OE të përgjegjshëm;

Përveç kësaj procedimi i shpenzimeve duhet të jetë klasifikuar dhe regjistruar në kodet adekuate.

Çështja 9 - Pagesë për punët e pa përfunduara- Prioritet i lartë

- E gjetura** Për ndërtimin e kanalit të Gogës për ujitje, komuna kishte nënshkruar kontratë në vlerë prej 100,000€. Për realizimin e këtij projekti, komuna ka paguar shumën prej 99,992€ për 1750 metra kanal të hapur. Komuna kishte ekzekutuar pagesa duke u bazuar në raportin e organit mbikëqyrës dhe komisionin e pranimit teknik, i cili kishte pranuar kryerjen e punimeve. Në muajin shkurt 2015 ne ekzaminuam punimet në terren dhe vërejtëm se ishin kryer vetëm 1062 metra kanal me një vlerë ekuivalente 56,888€. Ne informuam Kryetarin e Komunës për mangësitë e identifikuar në ekzekutimin e projektit, dhe pas kësaj ai kishte marr masa duke eliminuar mangësitë e cekura më lartë. Kështu që me 20.03.2015 punimet ishin përfunduar.
- Rreziku** Menaxhimi i kontratës është përcjellë me mangësi. Pagesat e tilla nuk janë në pajtim me rregullat financiare mbi shpenzimin e parave publike dhe kryerja e pagesave para se punimet e kontraktuara të jenë kryer, rritë rrezikun që projektet të mos përfundohen apo të kenë kosto shtesë. Rast i njëjtë kur pagesa ishin bërë para se të kryhen punimet ishin raportuar edhe në raportin e auditimit për vitin 2013.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet të siguroj që rasti i kanalit të Gogës është rishqyrtuar dhe të analizohen pse dështimet në proces kanë ndodhur, shtoj kontrollet monitoruese për të siguruar se situata të tilla nuk do të përsëriten në të ardhmen dhe ndërmerr masa administrative aty ku nevojiten. Komisioni duhet të mbahet llogaridhënës dhe duhet të merren masa administrative.

4.3.2 Shpenzimet tjera

Çështja 10 - Dobësitë jo sistematike - Prioritet i lartë

- E gjetura** Ne kemi testuar pagesat në vlerë 39,702€ dhe kemi vërejtur se komuna kishte investuar në disa fshatra në rrjetin e shpërndarjes të energjisë elektrike. Investimet në rrjetin elektrik janë përgjegjësi e kompanisë private për distribuimin e energjisë elektrike (KEDS) e jo përgjegjësi e komunës.
- Rreziku** Investimi në pronë private përveç që është tejkalim i kompetencave të komunës, paraqet rrezik se vlera e investimit në rrjetin shpërndarjes të energjisë nuk mund të regjistrohet si aset i komunës.
- Rekomandimi 10** Kryetari të siguroj që të mos bëjë investime në asete private dhe të respektoj kompetencat e tij konform Ligji të Vetëqeverisjes Lokale.

Çështja 11 - Transfer i mjeteve në mungesë të aprovimit nga MF - Prioritet i lartë

- E gjetura** Ne testuam pagesat për projektet kapitale dhe identifikuam katër raste në vlerë 66,782€, ku fondet e parapara me ligjin e buxhetit për vitin 2014 nuk ishin shfrytëzuar për ato projekte të buxhetura. Fondet e tilla ishin shfrytëzuar për realizimin e projekteve të tjera të cilat po ashtu ishin të buxhetura. Bartja e këtyre mjeteve në projekte tjera nuk ishte bërë në harmoni me rregullën financiare të shpenzimit të parasë publike Nr. 01/2013, ku kërkohet që kërkesa të dërgohet në MF.
- Rreziku** Transferi i mjeteve në kundërshtim me rregullat e thesarit rritë rrezikun që fondet publike të shpenzohen jashtë rregullave të përcaktuara dhe projektet e parashikuara të mos realizohen.
- Rekomandimi 11** Kryetari duhet të siguroj realizimin e projekteve sipas planifikimit të buxhetit dhe në rastet e bartjes së mjeteve prej një projekti në projekte tjera të zbatoj kornizën rregullative në fuqi.

4.3.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 5,068,024€ ndërsa shpenzimet për këtë kategori janë 5,046,011€ apo 99%.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me a) kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave, b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Për këtë kategori testuam 54 mostra ku rishikuam pajtueshmërinë e kontratave të punës me listën e pagave në payroll. Po ashtu, kemi shikuar nëse pozitat e zyrtarëve dhe koeficientët janë në pajtueshmëri me formën e sistemit të pagave. Ne identifikuam çështjet si në vijim:

Në janar 2015 Komunën e Istogut kishte mungesë të mjeteve në vlerë 4,281€ në dy nën programe në Drejtoratin e Arsimit për shkak të pushimeve të lehonave. Komuna e Istogut me datën 16.02.2015 kishte bërë kërkesë për transfer të mjeteve nga programi i arsimit të mesëm në programin fillor dhe MF e kishte aprovuar kërkesën e komunës me 23.02.2015.

Çështja 12 - Mos harmonizim i pozitive të punës në mes kontratave dhe listës së pagave (payrollin) - Prioritet i mesëm

E gjetura Komuna e Istogut që nga viti 2010 ka në listën e pagave 16 udhëheqës të personelit. Kjo kishte ndodhur për shkak se drejtorët e drejtorive komunale në vitin 2010 kishin marr vendime për ngritjen e koeficienteve nga 7.5 në 9.5 për 16 punonjës. Komuna e Istogut me kontratë pune ka vetëm një udhëheqës të personelit derisa të tjerët me kontrata të punës janë: certifikues, shpenzues, udhëheqës sektorësh, koordinator për barazi gjinore, etj.

Zyra e personelit ende nuk ka arritur të mirëmbaj dosjet e personelit në formë elektronike, siç parashihet me rregulloren 03/2011 për dosjet e personelit. Po ashtu, edhe në drejtoratin e shëndetësisë kemi testuar gjashtë mostra dhe identifikuar që në dosjet e personelit mungonin vlerësimet vjetore për vitin 2014.

Rreziku Rritja e koeficienteve për 16 punonjës krijon një pakënaqësi në mes të punëtorëve në administratën komunale. Ngritja e koeficienteve nuk është kompetencë e drejtorëve të drejtorive komunale dhe anashkalon përgjegjësitë e Kryetarit në marrjen e vendimeve (neni 13 i ligjit për vetëqeverisje lokale e autorizon se vetëm kryetari ka të drejtë të marr vendime apo urdhëresa të caktuara).

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të rishikoj çështjen e ngritjes së koeficientëve dhe të siguroj që në sistemin e pagave të mos figurojnë 16 udhëheqës të personelit. Veç kësaj, të siguroj që dosjet e personelit të mbahen edhe në formë elektronike.

4.3.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Komuna e Istogut për vitin 2014 kishte planifikuar buxhetin 285,328€ ndërsa kishte shpenzuar 168,359€.

Komuna e Istogut kishte adresuar rekomandimin e vitit paraprak duke nxjerr dhe aprovuar në kuvendin komunal rregulloren e brendshme për ndarjen e subvencioneve. Kjo rregullore ishte aprovuar me 30.06.2014.

Rekomandimi

Ne nuk kemi identifikuar ndonjë çështje të rëndësishme për të adresuar.

4.4 Pasuritë dhe detyrimet

4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Ne vërejtëm se komuna ka vazhduar procesin e regjistrimit të pasurive në SIMFK dhe kishte një progres krahasuar me vitin e kaluar. Në PVF e vitit 2014 komuna ka prezantuar pasuri neto në vlerë 12,262,984€ që krahasuar me vitin 2013 kishte 10,556,261€. Pra kemi një rritje neto prej 1,706,723€.

Aktiviteti i komunës në regjistrimin e pasurive është domethënës ngase vetëm në vitin 2014 ka arritur të regjistroj në regjistrin kontabël vlerën 2,188,234€. Mirëpo ende nevojitet punë deri në krijimin e regjistrit përfundimtar.

Ne testuam pasuritë e komunës të dhëna me qira (tokat) në sipërfaqe 90 hektarëve, të cilat nuk janë të regjistruara në Regjistrin Kontabël.

Çështja 13 - Mos regjistrimi i plotë i pasurisë dhe mungesa e hartimit të raporteve nga komisioni për regjistrim dhe inventarizim - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna ka arritur të identifikoj 1540 parcela komunale që janë në pronësi të komunës, por ende nuk ka arritur të regjistroj në regjistrin kontabël për shkak se pronat nuk kanë vlerë financiare.

Komuna nuk kishte formuar komisionet për inventarizim dhe vlerësim të pasurive në fund të vitit, sipas udhëzimit administrativ. Komisioni i regjistrimit të pasurive është formuar me datën 09/01/2015, por nuk kishte prodhuar ndonjë raport për gjendjen e pasurive.

Rreziku Mos regjistrimi i plotë i të gjitha pasurive të cilat janë në pronësi të komunës, rritë rrezikun e nënvlerësimit të pasurive të komunës dhe paraqitjes jo të drejt të vlerës së pasurisë. Formimi me vonesë i komisioneve, rrit rrezikun e organizatës për humbje, keqpërdorim dhe përdorim të paautorizuar të pasurive.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të siguroj veprime konkrete që mundësojnë regjistrimin sistematik të të gjitha pasurive në regjistrat përkatës në pajtim me kërkesat e UA dhe raportimin e saktë dhe të plotë të pasurive. Po ashtu, në fund të çdo viti, të formoj komisionet me kohë dhe rezultatet e regjistrimit t'i azhurnoj në regjistrat e pasurisë.

4.4.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrim

Komuna e Istogut nuk kishte marr masa konkrete për zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme. Këto të arkëtueshme rezultojnë nga: tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, taksat në firmë (tanimë obligimet e bizneseve akoma nuk janë shlyer, edhe përkundër heqjes së taksës në firmë), dhënia e objekteve dhe pronës komunale me qira etj.

Çështja 14 - Trajtimi i llogarive të arkëtueshme -Prioritet i lartë

E gjetura Për vitin 2014 llogaritë e arkëtueshme janë 1,323,186€. Krahasuar me vitin paraprak (1,186,000€), ato janë rritur për 137,186€ apo afërsisht 11%.

Rreziku Politikat jo efikase të komunës për mbledhjen e të hyrave vetjake kanë rezultuar në rritjen e llogarive të arkëtueshme nga viti në vit dhe kjo redukton aftësinë e komunës për vetëfinancimin e projekteve.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të siguroj vendosjen e një plani strategjik për mbledhjen e të llogarive të arkëtueshme, duke i përcaktuar masat e qarta, afatet dhe personat përgjegjës për ekzekutimin e planit.

4.4.3 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Komuna e Istogut në fund të vitit 2014 kishte obligime të papaguara në vlerë prej 142,000€ ndërsa në vitin paraprak obligimet ishin 48,179€. Siç shihet obligimet e papaguara janë rritur për 93,821€ apo 66%.

Çështja 15 - Mos raportimi mujor i obligimeve në Thesar-prioritet i mesëm

E gjetura Komuna e Istogut nuk kishte raportuar obligimet mujore sipas nenit 5 të rregullores 02/2013 në Ministrinë e Financave-Thesar.

Veç kësaj, obligimet e papaguara janë rritur për 93,821€ në fund të vitit 2014.

Rreziku Mos raportimi i obligimeve të papaguara në Thesar përveç që është në kundërshtim me nenin 5 të rregullores së Thesarit 02/2013 për raportim të obligimeve paraqet rrezik që obligimet e komunës të mos pasqyrohen drejtë në PVF dhe vështirëson planifikimin e buxhetit për vitin vijues.

Rekomandimi 15 Kryetari duhet të siguroj që raportimi i obligimeve të papaguara të bëhet në Thesar në baza mujore dhe të ndërmerr masa që faturat të paguhen brenda afateve ligjore.

4.5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) kishte planifikuar pesë (5) raporte të auditimit në planin vjetor të auditimit derisa ka përfunduar dy raporte të auditimit gjatë vitit 2014. Raportet e auditimit, sipas vlerësimeve tona ishin të nivelit mesatar por për qëllime auditimi, ne nuk jemi mbështetur në ato raporte.

Komuna në tetor 2014 kishte themeluar Komitetin e Auditimit të Brendshëm

Çështja 16 - Mos arritja e NJAB në përmbushjen e planit vjetor të punës- Prioritet i mesëm

E gjetura

Njësia e auditimit të brendshëm as përafërsisht nuk kishte përmbushë planin vjetor të punës. Kjo njësi kishte kryer dy raporte të auditimit për fushën e prokurimit ku fokusi ishte viti 2013 për zyrën e prokurimit ndërsa në drejtoratin e shërbimeve publike, fushëveprimi ishte viti 2013 dhe 2014. Kontributet e ofruara nga auditimi i brendshëm nuk i ka ndihmuar menaxhmentit të kuptoj veprimin dhe efektivitetin e kontrolleve për të marr masat eventuale përmirësuese.

NJAB-i nuk e ka statutin e auditimit të brendshëm i cili përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë e menaxhmentit të lartë dhe auditimit të brendshëm.

Menaxhmenti (njësitë e audituara) nuk hartojnë plan për adresim e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

Këto gjetje sugjerojnë mungesë të vëmendjes për të ofruar përfitimet maksimale që një sistem i auditimit të brendshëm mund t'i jap Komunës.

Rreziku

Puna jo e mjaftueshme e auditimit të brendshëm i pamundëson menaxhmentit të ketë pasqyrë të qartë mbi funksionimin e kontrolleve të brendshme. Së këndejmi, dobësitë e identifikuara, nuk janë korrigjuar dhe vazhdojnë të përsëriten në vazhdimësi. Një program i papërfunduar i NjAB zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve financiare. Kjo mund të rezultojë me dobësi të pidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive që rezulton me humbje financiare për Komunën.

Rekomandimi 16 Kryetari duhet të siguroj që përmbushja e aktiviteteve të planifikuara të NjAB-it të monitorohet çdo tre muaj dhe të ndërmerren veprime proaktive, në mënyrë që auditimi i brendshëm të jetë më efektiv duke përmirësuar sistemin e kontrollit të brendshëm. NJAB-i duhet të hartoj dhe të nënshkruaj statutin e auditimit të brendshëm.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1. Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të sigurojë që plani i prodhimit të llogarive(PVF) për vitin 2014 formalisht adreson të gjitha kërkesat për pajtueshmëri lidhur me PVF-të, me fokus të veçantë në fushat e theksuara më lartë. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF lidhur me saktësinë e PVF-ve nuk duhet të dorëzohet pa u siguruar se janë zbatuar të gjitha kontrollet relevante para se ato t'i jenë dorëzuar Qeverisë.		Pjesërisht	
2.pasuritë	Prioritet i lartë - Kryetari i Komunës duhet të identifikoj arsyet për keq deklarimin fillestar të pasurive dhe dështimin për të ndjekur këshillat e ZAP. Procese të duhura duhet të vendosen në vitin 2014 për të siguruar se pasuritë komunale do të vlerësohen dhe të regjistrohen në regjistrat përkatës.			Pa adresuar
3. Raportimi i jashtëm	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se të gjitha kërkesat për raportim të jashtëm janë përmbushë në mënyrë cilësore dhe brenda afateve kohore të përcaktuara.		Pjesërisht	
4. Adresimi i rekomandimeve	Kryetari i Komunës duhet të hartoj një plan për adresimin e rekomandimeve dhe të diskutoj me stafin përgjegjës për mënyrën se si të adresohen rekomandimet e dhëna, të caktoj një afat kohor optimal, të zbatueshëm dhe të fokusohet në fusha të rëndësishë më të madhe (apo fushat me prioritet).	Adresuar		

5. Qeverrisja dhe kontrolli	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se një strukturë e përshtatshme qeverisëse është zbatuar përmes së cilës menaxhmenti i lartë është i informuar për mangësitë e kontrollit dhe në mënyrë aktive i menaxhon ato. Ky proces duhet të mbështetet me dorëzimin e vetëvlerësimit të kërkuar nga MF		Pjesërisht.	
6. Te hyrat vetjake-tatimi ne prone	Kryetari i Komunës duhet të shfrytëzoj burimet relevante të informatave para se ta aprovoj planin e të hyrave vetjake, si: trendi i inkasimeve nga vitet paraprake, baza ekonomike e taksapaguesve dhe fuqia e tyre paguese.			Pa adresuar
7. Te hyrat -lejet ndërtimit	Kryetari i Komunës duhet të rishikoj procedurat e dhënies së lejeve ndërtimore dhe të siguroj se taksat ndërtimore paguhen para se leja të lëshohet.	I adresuar		
8. Prokurimi	Kryetari i Komunës të siguroj që asnjë operator ekonomik nuk do të shpërblehet me kontratë nëse është i papërgjegjshëm dhe aty ku kontrollat nuk janë aplikuar, të përcaktohen arsyet dhe përgjegjësia të adresohet tek personat përgjegjës.		Pjesërisht.	
9. Pagesa pa përfunduar punimet	Kryetari i Komunës duhet ta rishqyrtojë rastin dhe të përcaktoj pse dështimet në proces kanë ndodhur, shtoj kontrollat monitoruese për të siguruar se situata të tilla nuk do të përsëriten në të ardhmen dhe ndërmerr masa administrative aty ku nevojiten			I pa adresuar
10. Subvencionet	Kryetari i Komunës duhet që pa vonesë të inicioj për miratim në Kuvend Komunal një Rregullore që specifikon qartë kriteret, formën e raportimit dhe burimet e subvencioneve. Gjithashtu, planifikimi më i mirë dhe zbatimi i buxhetit sipas ndarjeve fillestare, duhet të jetë objektiv i përhershëm i menaxhmentit.	I adresuar		

11. Llogarite e arkëtueshme	Kryetari i Komunës duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative nëse ka nevojë.		Pjesërisht.	
12. Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të punojë me NJAB-në për të zhvilluar një plan të bazuar në rreziqe i cili do të ofrojë siguri gjatë vitit 2014 mbi të gjitha fushat sinjifikante. Aty ku ka pasur rekomandime, menaxhmeti duhet në mënyrë aktive ta shqyrtojë një plan veprimi të zhvilluar për t'i adresuar rekomandimet e dakorduara brenda një afati kohor relevant. Po ashtu të shikoj mundësit për të shtuar stafin në NJAB.			Pa adresuar
13. Komiteti i auditimit të brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë themelimin e një Komiteti të Auditimit i cili aplikon praktikë të mirë dhe të sigurojë se auditimi i brendshëm kryen punën në mënyrë cilësore dhe në pajtim me standardet dhe praktikatat e mira	I adresuar		